



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 12664 prot.

Shkodër, më 29.5. 2026

**NJOFTIM
Për këshillim me publikun**

Në mbështetje dhe në zbatim të nenit 18 dhe nenit 54, shkronja "k", të Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", si dhe të Ligjit nr. 146/2014 "Për njoftimin dhe konsultimin publik", Këshilli Bashkiak i Bashkisë Shkodër njofton organizimin e një seance këshillimi me publikun, me qëllim diskutimin e dokumentit si më poshtë:

1. **Projektvendim:** *"Për miratimin e kërkesës për transferimin e sipërfaqes prej 200 m² të shoqërisë "Tregu i Shitjes me Shumicë Fruta-Perime" sh.a. pranë Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural."*

Takimi do të zhvillohet ditën e premte, më datë **26 qershor 2026**, ora **14:00**, në sallën e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak Shkodër.

Sugjerimet dhe komentet mund të dorëzohen deri në përfundim të afatit të konsultimit, konkretisht deri më datë **26 qershor 2026**, në formë të shkruar:

- pranë zyrës së protokollit të Bashkisë Shkodër;
- me postë;
- nëpërmjet postës elektronike në adresën: keshilibashkiak@bashkiashkoder.gov.al.

Ftojme qytetarët, grupet e interesit dhe çdo palë të interesuar të marrin pjesë aktivisht në këtë proces këshillimi me publikun.

Duke ju falënderuar,

SEKRETARE

Sabina Danaj

